

SAKRAMENTET E KISHËS KATOLIKE



SAKRAMENTET E KISHËS KATOLIKE



- **BURIMET ZYRTARE:**

Websiti zyrtar i Katekizmit të Kishës Katolike: Vatican.va

Websiti zyrtar i Urdhrit Domenikan www.amici.domenicani.it;
RUBRICA: UN SACERDOTE RISPONDE; në të cilin besimtarët i bëjnë pyetje të shumëllojshme priftit domenikan, profesor teologjie, tomisti Atë Angelo Bellon;

Websiti zyrtar i priftit italian Don Leonardo Maria Pompei, prifti i Kishës Katolike Romane: *In Voluntate Dei*

SAKRAMENTET E KISHËS KATOLIKE



Sakramentet e hyrjes
në jetën e krishterë

Pagëzimi

Krezmimi

Eukaristia

Sakramentet e
shërimit

Rrëfimi


Vajimi

Sakramentet në
shërbim të bashkësisë
e të misionit të
besimtarëve

Martesa

**Urdhri i
Shenjtë**

Sakrament = shenjë e shenjtë



SAKRAMENTI I PAGËZIMIT



Çfarë ndodh gjatë sakramentit të pagëzimit?

1. Na liron nga mëkati

Nga mëkati origjinal, nga të gjitha mëkatet nqs ai që pagëzohet është i rritur dhe nga dënimi që rrjedh nga mëkatet e bëra

2. Na bën bir/bij të Zotit

E drejta për të marrë në trashëgimi Parajsën

3. Na bën gjymtyrë të Krishtit

Gjoni 15, 5: Unë jam hardhia, ju jeni degët

4. Na bën pjesë të Kishës dhe të misionit të saj

Nuk lindim të krishterë, por bëhemi të krishterë vetëm nëpërmjet Pagëzimit



A MUND TË ANULLOHET APO TË PËRSËRITET PAGËZIMI?

Jo!

Në asnjë lloj mënyre nuk mund të fshihet, eliminohet, anulohet apo përsëritet pagëzimi i marrë.

Pagëzimi është një vulë shpirtërore.



A ËSHTË I NEVOJSHËM PAGËZIMI PËR SHPËTIMIN?

Po.

Kisha nuk njihet tjetër të
zakonshëm përveç Pagëzimit për
shpëtimin e shpirtit, pra për të
shkuar në Parajsë.



PAGËZIMI DHE JO TË KRISHTERËT



PO ATA QË NUK JANË TË PAGËZUAR A KANË MUNDËSI SHPËTIMI?

Po.

Rruga e zakonshme dhe më e sigurtë me anë të së cilës merret hiri është Pagëzimi, por ka edhe rrugë të jashtëzakonshme që vetëm Zoti i di, që ai i përdor, për t'i dhënë krijesave të tij hirin dhe për t'ja shpëtuar shpirtin.

«Zoti Shpëtimtari ynë do që çdo njeri të shpëtojë e të arrijë të njohë Hyjin» (Letra e parë drejtuar Timoteut, 2, 3-4)

Kisha pohon që nqs një njeri pagan, që nuk e njeh Zotin që njohim ne të krishterët, sillet në mënyrë të tillë që e ndjek ndërgjegjen e tij, në të cilën Kisha thotë që flet Zoti, pra që ndjek të mirën e i largohet së keqes, duhet të jemi të sigurtë që Zoti do t'i tregojë për frymëzim të brendshëm gjërat që ai apo ajo duhet të besojë për të shpëtuar shpirtin ose do t'i dërgojë ndonjë predikues së fesë siç bëri me Shën Pjetrin e me Kornelin në Veprat e Apostujve 10, 24-34, 36; 44-48.



- Ditën e dytë arriti në Cezare. Korneli i priste; kishte grishur edhe farefisnin e disa miq të ngushtë. Kur Pjetri arriti, Korneli i doli para e, duke rënë ndër këmbët e tij, e adhuroi. Pjetri e ngriti në këmbë dhe i tha: “Çohu në këmbë se edhe vetë jam vetëm njeri!” E, duke biseduar me të, hyri brenda, ku gjeti të bashkuar shumë njerëz, të cilëve u tha:


- “Ju e dini mirë se një hebre e ka të ndaluar shoqërimin me të huaj ose t’u hyjë në shtëpi, porse vetë Hyji më mësoi se s’është e lejueshme të quhet i ndytë ose i papastër asnjë njeri. Prandaj, kur më grishët, erdha pa kundërshtuar. Tani dëshiroj të di pse më keni grishur.”

- “Para katër ditësh - iu përgjigj Korneli - pikërisht në këtë kohë, thosha në shtëpinë time lutjet e orës nëntë, kur ia behu një njeri në petka të shkëlqyeshme, zuri vend para meje dhe tha: ‘Kornel, u vështrua lutja jote dhe u kujtuan lëmoshët e tua para Hyjit. Dërgo, pra ndokënd në Jopë dhe grise Simonin e quajtur Pjetër. Ai është mik në shtëpinë e Simonit lëkurëtar, afër detit.’ Menjëherë dërgova njerëzit për ty dhe ti bëre mirë që erdhe. Ja, pra, të gjithë jemi bashkuar para Hyjit për të dëgjuar gjithçka Zoti të ka urdhëruar.”

- Atëherë Pjetri mori fjalën e tha:

- “Tani me të vërtetë po e marr vesh se Hyji nuk i mban kujt krah. Ai u dërgoi Fjalën e vet izraelitëve dhe ua shpalli Ungjillin e paqes përmes Jezu Krishtit që është Zotëria i të gjithëve.

- ... Ndërsa Pjetri ende po i thoshte këto fjalë, Shpirti Shenjt zbriti mbi të gjithë ata që po dëgjonin predikimin. Besimtarët e rrethprerë që kishin ardhur me Pjetrin, u çuditën kur panë se edhe në paganë u ndikua dhurata - Shpirti Shenjt. Sepse i dëgjuan duke folur gjuhë të ndryshme e duke madhëruar Hyjin. Atëherë Pjetri tha: “Vallë a mund ta ndalojë kush ujin të mos pagëzohen këta që e morën Shpirtin Shenjt sikurse edhe ne?” Dhe urdhëroi të pagëzohen në emër të Jezu Krishtit. Atëherë iu lutën të qëndrojnë me ta disa ditë.



PO PËRSA I PËRKET SHPËTIMIT TË NJERËZVE QË I PËRKASIN FEVE TË TJERA?

- Ata që pa patur faj e injorojnë Ungjillin e Krishtit dhe Kishën e tij por që sidoqoftë e kërkojnë Zotin me sinqeritet dhe me ndihmën e hirit të tij mundohen që të bëjnë nëpërmjet veprave vullnetin e tij, të cilin e njohin nëpërmjet asaj çka u thotë ndërgjegja, mund të arrijnë shpëtimin e amshuar. (Lumen gentium 16)

Po atëhere pse të predikojmë Ungjillin e Krishtit për shpëtimin dhe pse të predikojmë pagëzimin atyre të feve të tjera?

- Edhe pse në fetë e tjera mund të ketë elemente të mira dhe të vërteta, dhe këto elemente mbahen nga Kisha si një parapërgatitje për të hapur zemrën ndaj Ungjillit, si elemente të dhëna nga Ai që ndriçon çdo njeri, që të ketë jetën e vërtetë; shumë shpesh, fatkeqësisht, njerëzit janë të gënjyer nga i keqi duke gabuar në arsyetimet e tyre dhe duke e shkëmbyer të vërtetën hyjnore me gënjeshtëri e duke shërbyer krijesat në vend të Krijuesit, ose duke përfunduar jetën e tyre pa e njohur Zotin e vërtetë e pa jetuar me të e për të. Për këtë arsye, Kisha, për të promovuar shpëtimin e këtyre njerëzve, duke kujtuar urdhrin e Zotit tonë Jezu Krishtit "Predikojeni ungjillin cdo krijese" (Mk 16,15) kujdeset tej mase për mbështetjen dhe inkurajimin e misionëve. (Lumen Gentium 16)

"Predikojeni ungjillin çdo krijese" (Mk 16,15)



KUSH MUND TË PAGËZOJË?



- Kushdo mund të pagëzojë, vetëm duhet të ketë qëllimin të bëjë atë që bën Kisha nëpërmjet Pagëzimit.

Pse?

Sepse Pagëzimi është sakrament i domosdoshëm për shpëtimin e shpirtit; është sakramenti që e rigjeneron njeriun në jetën e mbinatyrshme të Hyjit. Pra, që të mos i mungojë njeriut në asnjë lloj mënyre një ilaç kaq i rëndësishëm dhe i domosdoshëm.

Kuptohet që kjo vlen në ato raste kur njeriu që do të pagëzohet është në gjendje rreziku për jetën dhe kur ministri i zakonshëm i Pagëzimit, pra prifti, nuk gjendet në ato momente.

PAGËZIMI DHE FETË E TJERA



PAGËZIMI E FEJA ORTODOKSE

- Feja ortodokse ka të përbashkët me fenë katolike fuqinë e Urdhrit: pra feja ortodokse ka priftërinj të shuguruar, të vlefshëm të cilët kryejnë sakramentin e pagëzimit të vlefshëm.
- Kjo do të thotë që nëq një njeri i pagëzuar në Kishën Katolike, kalon për ndonjë arsye, tek Kisha Ortodokse, ai është i pagëzuar dhe nëq priftërinjtë e Kishës Ortodokse të vendit ku shkon i kërkojnë që të pagëzohet sërish sepse për ta sakramenti i celebruar në kishën Katolike nuk vlen, kryhet një sakrilegj, pra një mëkat shumë i rëndë, dhe pagëzimi që ka qenë kryer në Kishën Katolike bëhet jo i frytshëm.



PAGËZIMI E FEJA PROTESTANTE

- Përsa i përket fesë protestante, duke qenë se ata nuk e kanë vazhdimisinë apostolike, me anë të së cilës sigurohet prania e sakramentit të urdhrit të vlefshëm, që na garanton priftërinjtë shuguruar të vlefshëm, dhe si pasojë edhe prania e sakramenteve të vlefshme nga ana e këtyre të fundit,
- mund të përdorim kriterin sipas të cilit thamë që "kushdo mund të pagëzojë, mjafton që të ketë qëllimin të bëjë atë që bën Kisha". Atëhere, si rrjedhojë, duke qenë se në fenë protestante ka rrymë të shumta të ndryshme midis tyre, duhet të dallojmë:
 - ❖ Për ato Kisha protestante që besojnë në Trininë e Shenjtë, pagëzimi është i vlefshëm
 - ❖ Për ato Kisha protestante që nuk besojnë në Trininë e Shenjtë, pagëzimi nuk është i vlefshëm



PAGËZIMI E DËSHMITARËT E JEHOVAIT

- Duke qenë se Dëshmitarët e Jehovahit mohojnë hyjninë e Jezu Krishtit dhe mohojnë Trininë e Shenjtë, atëherë ato gjatë pagëzimit që bëjnë, patjetër nuk kanë qëllimin që të bëjnë atë që bën Kisha (dmth të pagëzojnë në emër të Trinisë së Shenjtë). Për këtë arsye, pagëzimi i bërë në Dëshmitarët e Jehovahit është null, i pavlefshëm.
- Kjo do të thotë që nqs një njeri, që është pagëzuar ndër Dëshmitarët e Jehovahit, vendos të bëjë pjesë në Kishën Katolike, duhet të fillojë rrugën e katekumenatit nga fillimi, pra të marrë pagëzimin në Kishën Katolike.



PAGËZIMI I FËMIJËVE



KUR DUHET TË BËHET PAGËZIMI I FËMIJËVE?

- ❖ Pagëzimi, duke qenë se e liron fëmijën nga mëkati original, pra nga influenza djallëzore e vërtetë, reale, ekzistuese e vepruese, duhet të bëhet sa më parë të jetë e mundur, pa pritur gjëra të tjera që mund të konsiderohen sipërfaqësore në krahasim me sakramentin në vetvete, edhe pse për ne njerëzit janë shumë të rëndësishme.
- ❖ Kisha nuk cakton një kohë fikse, ndërkohë që përpara ka qenë koha e caktuar brenda 8 ditësh, por thotë sa më shpejt, brenda javëve të para të lindjes së fëmijës.



ÇFARË NDODH ME FËMIJËT QË VDESIN PA MARRË PAGËZIMIN?

- Mëkati origjinal nuk është mëkat personal i bërë nga fëmija, por gjithsesi pengon prezencën e hirit të Zotit, pa të cilin, asnjë njeri nuk mund të futet në Parajsë. Normalisht këto fëmijë nuk mund të shkojnë as në Purgator, as në ferr, sepse nuk kanë mëkate të vogla për të purifikuar dhe as mëkate të rënda për të cilët nuk janë penduar.
- *Po ku shkojnë atëhere?*
- Përpara mendohej (mund të përmendim Papa Pio X (1835-1914), si edhe një mistike austriake Maria Simma (1915-2004)) që për arsyt e lartpërmendura, fëmijët që vdesin pa pagëzim shkojnë në të ashtuquajturin *limbo*, në të cilin nuk ka asnjë lloj vuajtjeje, por nuk është as Parajsa. Duke qenë ky thjesht një "përfundim teologjik« dhe jo një dogmë e fesë katolike, me kohën teologët janë thelluar mbi këtë argument.
- Sot Kisha thotë: Fëmijët që vdesin pa pagëzim, Kisha i vë në duart e Mëshirës Hyjnore dhe ka shpresë të madhe që ka një rrugë shpëtimi që Zoti i ofron këtyre fëmijeve të vdekur pa pagëzim (KKK 1261).





Ia sillnin fëmijët që të vinte dorën mbi ta, por nxënësit ua ndalonin. Jezusit, kur i pa, i erdhi keq dhe u tha: “Lërin fëmijët të vijnë tek unë e mos i ndaloni; sepse atyre u përket Mbretëria e Hyjit!
(Marku 10, 13-14)

Pse ta pagëzojmë fëmijën që të vogël në vend që të zgjedhë vetë ai kur të rritet?


- ❖ Pagëzimi, që shënon hyrjen në jetën e krishterë, nuk është vetëm një sërë ritualesh që përcaktojnë një identitet fetar, por është më shumë se kaq. (Shiko «Çfarë ndodh gjatë sakramentit të pagëzimit»).
- ❖ Dihet që edhe përsa i përket jetës natyrore, në vitet e para të jetës është prindi që kujdeset për fëmijën, në të gjitha aspektet: në të veshurit, në të ushqyerit, në shkollim etj.
- ❖ Nqs prindërit e edukojnë me të vërtetë fëmijën ashtu siç duhet në fenë e krishterë, që nuk është thjesht një sërë normash morale, por është vetë jeta hyjnore e Jezu Krishtit brenda nesh dhe miqësia e thellë me të, fëmija jo vetëm që nuk do ta ndjejë si imponim pagëzimin, por edhe do t'i falendërojë për të gjithë jetën prindërit për këtë dhuratë me vlerë të pafund.



PSE FËMIJËT PAGËZOHEN TË VEGJËL KUR VETË JEZUSI ËSHTË PAGËZUAR I RRITUR?

Jezusit, duke qenë hebre, i është bërë rituali i rrethprerjes në të tetën ditën nga lindja e tij, ashtu sikur përshkruante ligji hebraik në atë kohë, të cilin prindërit e tij e respektonin me perfeksion. Ky ritual për hebrejtë i korrispondon sakramentit të pagëzimit për të krishterët.

Kur u mbushën tetë ditë për të rrethprerë Foshnjën, ia ngjitën emrin Jezus, siç e quajti engjëlli para se të zihet në krahavor. (Luka 2,21)



PSE FËMIJËT PAGËZOHEN TË VEGJËL KUR VETË JEZUSI ËSHTË PAGËZUAR I RRITUR?

Atëherë erdhi Jezusi prej Galilesë në Jordan te Gjoni për t'u pagëzuar prej tij. Gjoni donte t'i kundërshtonte e i thoshte: “Mua më duhet të pagëzohem prej teje, e ti po vjen tek unë?” Por Jezusi iu përgjigj: “Lëre tani! Sepse kështu na ka hije të kryejmë çdo gjë që përkon me vullnetin e Hyjit.” Atëherë e lejoi. Menjëherë pas pagëzimit Jezusi doli nga uji. Dhe, ja! Iu hapën qiejt dhe e pa Shpirtin e Hyjit duke zbritur porsì pëllumb e duke ardhur mbi të. Dhe, ja, një zë që vinte nga qielli, tha: “Ky është Biri im i dashur, të cilin e kam për zemër!” (Mateu 3, 13-17)

- ❖ Jezusi ka marrë pagëzimin nga Gjon Pagëzuesi në lumin Jordan, kuptimi i të cilit ishte që të fuste në një gjendje pendese, në pritje të Mesisë Kuptohet, nga pjesa biblike, që Jezusi nuk pagëzohet për këtë arsye Përkundrazi, Jezusi e lejon Gjonin që ta pagëzojë, që të ndodhë ajo që lexuam e të dëgjohej publikisht zëri i Zotit që i thotë që Ai është Biri im i dashur.
- ❖ Në fakt vetë Gjon Pagëzuesi e pranon që pagëzimi që ai jepte njerëzve është krejt ndryshe nga ai që Mesia (pra vetë Jezusi) do të themelojë (që është pagëzimi që ne të krishterët marrim sot e kësaj dite):

Unë ju pagëzoj me ujë në shenjë kthimi, porse ai që po vjen pas meje, është më i fortë se unë e unë nuk jam i denjë as t'ia z bath sandalet: Ai do t'ju pagëzojë me Shpirtin Shenjt e me zjarr. (Mateu 3, 11)



KUSH MUND TË BËHET NUN/NUNESHË?

Nuni/nunesha:

1. përcaktohet nga prindërit apo nga përfaqësuesit e tyre ose nga vetë i pagëzuari nqs është i rritur
2. duhet të ketë mbushur të paktën 16 vjeç (përveçse nqs famulltari mendon se mund të bëjë ndonjë përjashtim)
3. duhet të jetë katolik, të ketë marrë sakramentet e Pagëzimit, të Kungimit e të Krezmimit dhe të jetojë një jetë që është e përshtatshme me rolin që ai ndërmerr.

Gjithashtu, përpara konsiderohej lidhja martesore/intime midis nunit e famulleshës si incest shpirtëror e prandaj nuk duhej të kishte lidhje të tilla midis tyre ose midis njerëzve të familjeve të tyre, por tashmë në Kodin e Ligjit Kanonik të ditëve tona kjo gjë nuk përmendet më.





RITUALI I PAGËZIMIT

Riti i mikpritjes

- ❖ Prifti që pagëzon dhe komuniteti katolik mikpret prindërit me fëmijën që do të pagëzohet në kishë, duke i pyetur për emrin e fëmijës.
- ❖ Vendosja e një emri të krishterë fëmijës është shumë e këshillueshme, sepse shenjt i emrit do të bëhet shenjt mbrojtës i veçantë i fëmijës gjatë gjithë jetës së tij.
- ❖ Ndryshimi ose vendosja e emrit përmendet shpesh edhe në Testamentin e Vjetër, pasi Zoti nëpërmjet përcaktimit të një emri krijesës së tij, i jepte kështu misionin e veçantë për realizimin e projekteve hyjnore.
- ❖ Zanafilla 35,10:

Kyji i tha «Emri yt është Jakob. Nuk do të quhesh më Jakob, por Izrael do të jetë emri yt». Kështu e quajti Izrael.



Shenja e Kryqit

- Është shenja e parë, për ne mund të duket diçka normale, e zakonshme, por ka një domethënie të thellë: Jezu Krishti e ka themeluar pikërisht në kryq sakramentin e pagëzimit, dhe nga kraharori i tij kanë dalë gjak e ujë, që simbolizojnë respektivisht Pagëzimin e Eukaristinë. Atëhere shenja e kryqit në fillim të celebrimit të Pagëzimit simbolizon vulën e përjetshme të Krishtit mbi atë njeri, që ai njeri i përket tashmë Krishtit, dhe Krishti i ka fituar hirin e shpëtimit këtij njeriu nëpërmjet Kryqit të tij të shenjtë.
- 1Pjetri 2, 24:

Ai në trupin e vet i mori mbi drurin e kryqit mëkatet tona, që, të vdekur për mëkate, të jetojmë për drejtësi: me plagat e të cilil jeni shëruar.



Shpallja e Fjalës së Zotit

- Fjala e Zotit e shpallur e ndriçon të vërtetën e zbuluar dhe nxit në njeriun që do të pagëzohet (kandidati) e në asamblenë që merr pjesë në Pagëzim, përgjigjen ndaj fesë. Pagëzimi është shumë i lidhur me fenë: normalisht nëq kandidati nuk beson në të vërtetat e zbuluara nga Jezu Krishti dhe nga Kisha e tij Katolike, sakramenti i pagëzimit nuk do të kishte asnjë lloj kuptimi, përveçse do të ishte krejt i pafrytshëm.
- Mk 16, 15-16:

Dilni në mbarë botën e predikojani Ungjillin të gjithë njerëzve. Kush do të besojë e do të pagëzohet, do të shëlbohet, ndërsa kush s'do të besojë, do të dënohet.



Predikimi i priftit

- **Omelia e priftit**, me lutjen e besimtarëve që i luten Zotit për kandidatin, për nunin e për prindërit e tij; pastaj bëhet lutja për ndërmjetësimin e shenjtërve (litanitë e shenjtërve) të cilët janë shembuj për ne e sidomos për kandidatin, pasi falë pagëzimit që e kanë jetuar plotësisht e thellësisht, janë bërë shenjtër e mund të gëzojnë përjetësisht me Zotin.

- Ef 2, 19:

Prandaj, nuk jeni më të huaj e mërgimtarë, por jeni bashkëqytetarë të shenjtërve dhe anëtarë të familjes së Hyjtit.



Lutja e ekzorcismit

- Duke qenë se një i pa pagëzuar është nën pushtetin e djallit, mbi kandidatin bëhen një (ose më shumë) ekzorcisma, për ta liruar nga mëkati e nga pushteti i djallit.
- Rm 6,22:

Tani, pasi jeni të liruar nga mëkati e u bëtë shërbëtorët e Hyjtit, jepni fryte që ju çojnë në shenjtërim, e si rrjedhim është - jeta e pasosur.

A vibrant field of red poppies stretches towards a bright sunset. The sun is low on the horizon, casting a warm, golden glow over the scene. The poppies are in various stages of bloom, with some fully open and others as buds. The background is a soft, hazy mix of orange and yellow, suggesting a vast, open landscape.

Lyerja me vajin e katekumenëve

- Ky vaj është shenjë force dhe kurajoje në betejën shpirtërore kundër satanit që çdo i krishterë është i detyruar të përballojë gjatë jetës dhe mundësisë së fitores mbi të keqen falë pagëzimit që po bën. Edhe gladiatorët në antikitet lyheshin me vaj, për t'i ikur armikut që u vihej pas.

*Psalmi 23,5: Ti ma shtron tryezën përparandër sy të armiqve të mi,
me vaj erëmirë kokën ma lyen, gotën ma mbush plot e përplot.*

- Më tej kandidati (ose prindërit dhe nuni/nunesha nëq është fëmijë) i bien mohit satanit haptas dhe shpallin fenë e Kishës Katolike (Unë besoj...).

Uji i pagëzimit

- Ky ujë shugurohet nëpërmjet një lutjeje të quajtur epiklesi, pra Kisha i kërkon Zotit që përmes Birit të tij, të zbresë mbi këtë ujë fuqia e Shpirtit të Shenjtë, në mënyrë që ai që do të pagëzohet të lindë "nga uji e nga Shpirti"

- Gjoni 3,5:

Përnjëmend, përnjëmend po të them: kush nuk lind me anë të ujit e të Shpirtit nuk mund të hyjë në Mbretërinë e Hyjit.





Riti themelor i sakramentit

- Ky rit simbolizon atë çka Pagëzimi është në vetvete: vdekja ndaj mëkatit dhe hyrja në jetën hyjnore të Trinisë së Shenjtë. Është përdorur uji, themelor e i domosdoshëm për pagëzimin, sepse edhe kuptimi i tij është domethënës: uji përfaqëson nga njëra anë vdekjen sepse në të ne njerëzit nuk do të mund të jetojmë, e nga ana tjetër jetën sepse pa të po ashtu nuk mund të jetojmë; pikërisht sikur kuptimi i vetë pagëzimit.
- Kjo ndodh konkretisht kur kandidati zhytet tre herë në ujin e pagëzimit (ose derdhet për tre herë uji i pagëzimit në kokën e kandidatit). **Ky rit, në liturgjinë latine, shoqërohet nga fjalët (formula sakramentale): Unë të pagëzoj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt.** Kurse në liturgjinë orientale, ndërkohë që katekumeni është i drejtuar nga Lindja, prifti thotë: "Shërbëtori i Hyjit (emrin...) pagëzohet në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt. Dhe, kur thotë emrin e secilit Person të Trinisë së Shenjtë, e zhyt në ujë dhe e nxjerr sërish.
- Psalmi 2,7: *Pi më tha: "Ti je im Bir, unë sot të linda!"*

Vajosja me krizmën e shenjtë

Vajosja me krizmën e shenjtë, pra vaj i parfumosur i shuguruar nga Ipeshkvi, nënkupton dhuratën e Shpirtit të Shenjtë që i është dhënë të sapo pagëzuarit. Ai tashmë është bërë i krishterë, pra i shuguruari, i vajosuri i Shpirtit Shenjt dhe bëhet kështu mbret, prift e profet, që janë thirrja e çdo të krishteri.



MBRET: pjesëmarrës së mbretërisë së Krishtit dhe ndjekësit e tij jo për t'u shërbyer, por për të shërbyer, pra të qenit mbret në një mënyrë tjetër, krejt ndryshe nga si e mendon bota

Marku 10, 45: *Biri i njeriut nuk erdhi për të qenë shërbyer, por që ai të shërbejë e të japë jetën e vet si shpërblim për të gjithë.*



Vajosja me krizmën e shenjtë

PROFET: nqs mendojmë që profeti është ai që sjell një mesazh nga Zoti, të gjithë ne, pasi e kemi zbuluar për vete e kemi një mesazh nga Zoti për të tjerët: Ungjilli i Krishtit, Ringjallja e tij.

Ligji i Përtërirë 18,18: *Do të ngre ndër ta, prej vëllezërve të tyre, një profet të ngjashëm me ty. Në gojën e tij do t'i vë fjalët e mia dhe ai do t'u flasë gjithçka unë kam për t'i urdhëruar atij.*



PRIFT: prifti është një ndërmjetës, ai që shërben si një urë lidhëse midis Zotit e njerëzve. Po ashtu edhe ne jemi të thirrur, që me pagëzimin, që të bëhemi ndërmjetës para Zotit me lutje, agjërime e vepra të mira për të gjithë vëllezërit e motrat, para Zotit.

Vap 12,5: *Kështu pra, Pjetri ruhej në burg, por lutja e përzemërt e Kishës ngritej vazhdimisht para Hyjtit për të.*

Në liturgjitë orientale, ky rit është Sakramenti i Krezmimit (Konfirmimit). Kurse në liturgjinë latine, ky rit lajmëron një tjetër vajosje me krizmën e shenjtë që do të bëhet më tej nga Ipeskvi pra Sakramentin e Krezmimit, i cilit e konfirmon dhe e plotëson këtë vajosje të pagëzimit.



Veshja e bardhë e Qiriu

- **Veshja e bardhë** simbolizon që i pagëzuari është veshur me Krishtin dhe që ka rilindur në Krishtin, duke lënë pas veshjen e vjetër të shënuar nga mëkati e nga egoizmi.
- *Luka 5, 36: Askush nuk e pret një copë prej pelkut të ri për t'ia vënë pelkut të vjetër, përndryshe shqyen pelkun e ri, kurse copa prej pelkut të ri nuk përkon me pelkun e vjetër.*
- **Qiriu**, që ndizet tek qiriu i Pashkëve, simbolizon faktin që Krishti me dritën e ringjalljes së tij e ka ndricuar të porsapagëzuarin. Pra në Krishtin cdo i pagëzuar është "drita e botës".
- *Mateu 5,14: Ju jeni drita e botës. Nuk mund të fshihet qyteti i ngritur në majë të malit.*



Riti «Effatà»

- Një nga ritet më të bukura të këtij sakramenti: effatà është një fjalë antike, në gjuhën aramaike, që do të thotë "çelu" dhe Jezusi ja ka thënë një shurdhmemeci, duke i prekur veshët e gjuhën për ta shëruar: po ashtu, për këtë arsye, prifti i prek fëmijës veshët e buzët, që të mund të dëgjojë e të shpallë Fjalën e Hyjit.

- Marku 7, 33-35:

Qi e ndau prej popullit veçmas, ia futi gishtërinjtë e vet në veshë, me pështymë të vet ia preku gjuhën, i drejtoi sytë kah qielli, psherëtiu dhe i tha: "Effatha - që do të thotë: "Çelu!" E menjëherë iu çelën veshët e iu zgjidh pengesa e gjuhës dhe foli rrjedhshëm.



A photograph of two young children sitting at a white table. The child on the left is a girl with brown hair, wearing a white shirt, with her hands clasped in prayer. The child on the right is a boy with brown hair, wearing a grey shirt, also with his hands clasped in prayer. In front of them is an open book with text on the pages. The background is a bright, slightly blurred indoor setting.

Lutja Ati ynë

- I pagëzuari i ri është tani bir i Zotit, dhe për këtë arsye mund të thotë lutjen Ati ynë, duke e thirrur me plot gojën Hyjin "ATË". Dhe kjo lutje bëhet duke afruar fëmijën tek alteri, si një shenjë e pjesëmarrjes së ardhshme të fëmijës në Sakramentin e Eukaristisë.
- Mateu 6, 9: *Prandaj lutuni kështu: Ati ynë që je në qiell, u shenjtëroftë Emri yt!*
- Në ritin latin Sakramenti i Kungimit jepet më tej, vetëm atyre që kanë arritur tashmë në përdorimin e arsyes, kurse në liturgjitë orientale Kungimi i shenjtë u jepet të gjithë të pagëzuarve e të krezmuarve, edhe fëmijëve të vegjël.



Bekimi solemn

- **Celebrimi i Pagëzimit përmbillet me bekimin solemn.** Në rastin e Pagëzimit të fëmijëve të vegjël edhe bekimi i nënës zë një vend shumë të rëndësishëm. Një arsye më shumë, sidomos për femrat, që të rrisin besimin e dashurinë për këtë Sakrament kaq të bukur, kaq të shenjtë, në mënyrë që bekimi i tyre, në mënyrë proporcionale me fenë dhe me dashurinë e tyre, të arrijë fort në zemrën e fëmijës.
- Zanafilla 27, 4: *Më përgatit ushqim siç e di se më pëlqen dhe ma sill ta ha që të të bekoj para se të vdes.*



Çfarë mendojnë mbi
Pagëzimin...?



Maria d'Agreda (1602-1665), murgeshë e mistike spanjolle

ÇFARË MENDONTE ZOJA MARI MBI PAGËZIMIN?

- Sipas së nderuarës Maria d'Agreda, e cila ka patur disa vizione të Zojës që i tregonte disa ngjarje të jetës së saj, të cilat ajo i ka shkruar në një libër të quajtur "Qyteti Mistik i Zotit". Ndër këto ngjarje, edhe të panjohura pra që nuk gjenden në Bibël, Zoja i tregon kësaj shenjtjeje se si ajo reagoi (kur ishte ende gjallë mbi këtë tokë), kur mori vesh nga Biri i saj Jezu Krishti se ai do të themelonte Sakramentin e Pagëzimit.
- Nga libri "**Città mistica di Dio (Qyteti mistik i Zotit)**", kap. 11; pjesa 831, i së nderuarës Maria d'Agreda:

«Pikë së pari (Zoja Mari) mori vesh që Ligji antik i rrethprerjes duhej të binte poshtë, duke hyrë në vend të tij sakramenti i mrekullueshëm i pagëzimit. Mori vesh që elementi i ndjeshëm i kësaj shenje të hirit hyjnor duhej të ishte uji i pastër dhe i thjeshtë dhe formula duhej të ishte thirrja e tre Personave hyjnore me emrat e Atit, Birit e Shpirtit Shenjt, në mënyrë që besimtarët të shpallnin në mënyrë të hapur fenë e tyre në Trininë e Shenjtë. Mori vesh gjithashtu të mirën që Krishti, Zoti ynë, do t'u komunikonte nëpërmjet pagëzimit: vulën efikase për të na shenjtëruar më mënyrë më perfekte dhe për ta na liruar nga të gjitha mëkatet dhe nga dënimet që rrjedhin si pasojë. Pa efektet e mrekullueshme që ky sakrament do të prodhonte në të gjithë ata që do ta kishin marrë, duke i bërë të rilindin dhe të rinovohen në gjendjen e fëmijëve të adoptuar dhe trashëgimtarë të mbretërisë së Atit të amshuar, duke derdhur në to virtytet e fesë, të shpresës e të dashurisë së bashku me shumë të tjera. Njohu po ashtu karakterin mbinatyor e shpirtëror që si një vulë mbretërore do të printohej, falë pagëzimit, në shpirtrat e tyre për t'i dalluar si bij/bija të Kishës së shenjtë. Po ashtu, gjithcka që ka të bëjë me këtë sakrament të shenjtë dhe efektet e tij ju bënë të njohur Marisë së Shenjtë. Ajo, menjëherë, më një dëshirë të zjarrtë, i kërkoi Birit të saj tejet të shenjtë që të mund ta merrte edhe ajo këtë favore kur t'i vinte koha; Madhëria e tij ja premtoi asaj, dhe pastaj ja dha pagëzimin, sic do të tregoi më tej».



Shën Agustini (354-430), filozof, teolog, ipeshkëv e doktor i Kishës

ÇFARË MENDONTE SHËN AGUSTINI MBI PAGËZIMIN?

- Nga libri "**Confessionis (Rrëfime)**" libri i nëntë, kap. 6, i Shën Agustinit një autobiografi në të cilën tregon se si ai, i lindur nga një nënë shumë devote katolike (shenjtja Monika) dhe nga një baba pagan, për shumë vite krejt larg fesë katolike, merr më në fund, së bashku me djalin e tij Adeodatin, 15 vjeçar, sakramentin e Pagëzimit, gjatë vigjiljes së Pashkës së vitit 387, në moshën 33 vjeçare:

“Kur erdhi momenti për të dhënë emrin tim për pagëzimin, e lamë fshatin dhe u kthyem në Milano. Alipio donte të rilindte edhe ai me mua. Ishte i veshur tashmë me përlësinë që i duhet sakramenteve të tua dhe e zotëronte kaq fort trupin e tij, sa e shkelte tokën italice të akullt këmbë zbatshur, gjë që kërkon një kurajo jo të zakonshme. Morëm me vete edhe djaloshin Adeodato, i lindur nga mishi im dhe fryt i mëkatit tim. Ti mirë e kishe bërë. Ishte vetëm 15 vjeç, dhe ja kalonte për inteligjencë shumë njerëzve intelektualë. I njoh dhuratat e tua, O Zot Hyji im, Krijues i gjithçkaje, aq i fuqishëm sa t'i japësh formë deformimeve tona; pasi nga unë në atë djalë nuk ishte vecse mëkati, dhe nqs u rrit nga ne në disiplinën tënde, ishte falë frymëzimit tënd, jo nga të tjerët. I njoh dhuratat e tua. Në një nga librat e mi, të titulluar "Mjeshtri" biri im bashkëbisedon me mua. Ti e di që të gjitha mendimet e vëna në atë libër nga personi i bashkëbiseduesit tim janë të tijat, që kur ishte 16 vjeç. Kam patur prova mbi shumë dhunti të tijat, akoma edhe më të jashtëzakonshme. Inteligjenca e tij më frymëzonte një terror të shenjtë; po kush tjetër, përveç Teje, mund të ishte autori i mrekullive të tilla? Sa shpejt e more jetën e tij nga kjo tokë, dhe kujtimi i tij është krejtësisht i qartë në mua, pasi nuk kam asgjë për t'u shqetësuar në lidhje me fëmijërinë e tij, me adoleshencën e tij dhe për tërë jetën e tij. Pra, e morëm me ne si një bashkëmohatar në hirin tënd, për ta edukuar në disiplinën tënde. E KËSHTU U PAGËZUAM E U LARGUA NGA NE SHQETËSIMI I JETËS SË KALUAR. Në ato ditë nuk ngopesha së sodituri me një ëmbëlsi të admirueshme planet e tua të thella mbi shëndetin e njerëzimit. Sa lotë të derdhur duke dëgjuar himnet dhe këngët e tua që jehonin ëmbëlsisht në kishën tënde! Një mallëngjim i dhunshëm: ato këngë derdheshin në veshët e mia dhe zbraznin në zemrën time të vërtetën, duke nxitur një ndjenjë të ngrohtë mëshire. Lotët që rridhnin më bënin mire”.

ÇFARË MENDONTE EDITH STEIN MBI PAGËZIMIN?

- **Edith Stein**, e lindur nga prindër gjermanë të fesë hebraike, pasi kalon shumë vite ateizmi në kërkim të së vërtetës, pagëzohet më 1 janar të vitit 1922, në festën katolike të Rrethprerjes së Jezusit (një ritual tipik i hebrenjve) duke marrë emrat e Teresa dhe Hedwig. Ajo ka vdekur viktimë në kampin e përqëndrimit në Auschwitz.
- Ajo, kur i kërkoi motrës së saj Erna që të përgatisë shpirtin e nënës së tyre për lajmin e kthimit në katolike; kjo e fundit thirri me zë të lartë: "Kjo është një nga gjërat më të vështira të jetës sime!"
- *"Ajo që nuk ishte në projektet e mia, bënte pjesë në projektet e Zotit. Gjithnjë e më shumë e gjallë bëhej brenda meje bindja se, duke e parë me dritën e Hyjit, asgjë nuk ndodh rastësisht: që e gjithë jeta ime, deri në detajet më të vogla, është përcaktuar nga provania hyjnore dhe që çdo ngjarje është vendosur sipas qëllimeve tejet të larta të planeve hyjnore... Më duket se tani shoh në mënyrë më të qartë dhe më të saktë detyrën time. Kjo do të thotë të shoh, gjithnjë e më thellësisht, shqetësimin tim, por në të njëjtën kohë edhe mundësinë e të qenit një instrument, pavarësisht nga gjithë paaftësia ime". (Teresia Renata e Shpirtit të Shenjtë, E. Stein, Ed. Morcelliana faq. 27).*



Edith Stein, emri fetar Shenjtja Teresa Benedetta della Croce (1891-1942) filozofe, murgeshë karmelitane e zbathur, mistike

FALEMINDERIT!

